



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 26.07.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.07.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "NNT" EING COM' për aktivitetin: "Ndertimi i parkut në lagjen Arbëria" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-362-121 nxjerr;

### V E N D I M

1. Pranohet pjesërisht kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "NNT EING COM" e datës 23.07.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i parkut në lagjen Arbëria" me Nr.616 18 2602 521 Nr. Brendshëm 616 18 026 521 kundër *Vendimit për dhënje të kontratës* të AK –së, të datës .07.2018, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Anullohet Vendimi për dhënje të kontratës i publikuar me datë: 19.07.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te aktivitetin ta kthej në rivlerësim*.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "NNT EING COM " me datë 23.07.2018 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i parkut në lagjen Arbëria" me numër të prokurimit 616 18 2602 521 dhe numër të brendshëm 616 18 026 521.

Autoriteti Kontraktues, me datë 25.07.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon për pretendimet për tenderuesin "Rexha SHPK":

1. Lidhur me pikën 1 pretendimi është i pa bazuar pasi që nuk ka qenë kërkesë e Autoritetit Kontraktues që të dorëzohen dëshmitë për regjistrim dhe në faturën e blerjes është cekur se traktori ka të gjitha paisjet;

2.Pretendimi i dytë është pjesërisht i bazuar,por nuk qëndron pretendimi për vëllimin e cisternës prej 20410 kgr,pasiqë ajo është vlera totale e Automjetit me ngarkesë e që d.t.th.se ngarkesa është më e vogël,por jo në kapacitetin e kërkuar;

3.Pretendimi për origjinën e fidaneve,poashtu është pjesërisht i bazuar,pasiqë është dorëzuar një Çertifikatë fitosanitare e brendshme,në të cilën nuk është cekur se ato fidane a janë prodhim i kompanisë apo janë të sjellura nga ndonjë vend tjetër;

4.Pretendimi për mungesën e standardit për lodra është i pa qëndrueshëm,pasiqë nuk është kërkesë e FDT-së,por është cekur te paramasa e që d.t.th.se secili tenderues që ka plotësuar paramasën është pajtuar edhe me përshkrimet e artikujëve në të njejten.

5.Pretendimi për garancion poashtu është i pa bazuar,pasiqë nuk është kërkesë nga FDT-ja,por nga përshkrimi në paramasë

Lidhur me pretendimet për tenderin e OE-ik"Alfa l'sqarojmë si vijon:

1.Pretendimi për mungesë të një kamioni është i bazuar,pasiqë nuk ka dëshmi për të njejtin;

2.Pretendimi për traktor është i pabazuar pasi që në faturë është cekur se traktori ka të gjitha paisjet e kërkuara;

3.Pretendimi për kapacitetin e cisternës është i bazuar,pasiqë kapaciteti i cisternës është ofruar është mbi kapacitetin e kërkuar;

4.Pretendimi lidhur me çertifikatë fitosanitare është i pa bazuar,pasiqë në tender është prezentuar çertifikata e OE-ik "Lulishtja Buçaj".dhe

5.Pretendimi për garancion është i pa bazuar,pasiqë kjo nuk është kërkesë e FDT-se por përshkrim nga paramasa e që d.t.th.se çdo tenderues kur e plotëson pajtohet me kërkesat nga përshkrimi.

Bazuar në konstatimet paraprake konkludojmë se lidhur me pretendimet pjesërisht të bazuara duhet të kryhet një proces i rivlerësimit dhe në harmoni me nenin 72 të kërkoen sqarimet plotësuese për pikat e cekura dhe pastaj të verifikohet përgjegjshmëria e tenderëve të Oe-ik të cekur në kërkesë dhe në këtë Vendim.

#### Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit